

ни дена ќе поднесе пријава до надлежниот јавен обвинител и во тој рок ќе го информира подносителот на барањето за преземените мерки.

Доколку инспекторот не постапи по известувањето од ставот 2 на овој член, жалителот во рок од пет работни дена има право да поднесе приговор во писарницата на министерот надлежен за работите од областа на трудот. Доколку министерот надлежен за работите од областа на трудот нема писарница барањето се поднесува во писарницата на седиштето на министерството.

Директорот на Државниот управен инспекторат е должен во рок од три работни дена од денот на приемот да го разгледа приговорот од ставот 6 на овој член и доколку утврди дека инспекторот не постапил по известувањето на жалителот од ставот 2 на овој член или не поднесе пријава согласно со ставот 5 на овој член, директорот на Државниот управен инспекторат ќе поднесе барање за поведување прекршочна постапка за прекршок утврден во Законот за управната инспекција за инспекторот и ќе определи дополнителен рок од пет работни дена во кои инспекторот ќе изврши надзор во надлежниот орган дали е спроведена постапката согласно со закон и во рок од три работни дена од денот на извршениот надзор да го информира подносителот на барањето за преземените мерки.

Доколку инспекторот не постапи и во дополнителниот рок од ставот 7 на овој член, директорот на Државниот управен инспекторат ќе поднесе пријава до надлежниот јавен обвинител против инспекторот и во рок од три работни дена ќе го информира подносителот на барањето за преземените мерки.

Во случајот од ставот 8 на овој член, директорот на Државниот управен инспекторат веднаш, а најдоцна во рок од еден работен ден, ќе овласти друг инспектор да го спроведе надзорот веднаш.

Во случаите од ставот 9 на овој член, директорот на Државниот управен инспекторат во рок од три работни дена ќе го информира подносителот на барањето за преземените мерки.

Доколку директорот на Државниот управен инспекторат не постапи согласно со ставот 7 на овој член, подносителот на барањето може да поднесе пријава против директорот до надлежниот јавен обвинител, во рок од осум работни дена.

Доколку министерот надлежен за работите од областа на трудот не одлучи во рокот од ставот 5 на овој член, подносителот на барањето може да поведе управен спор пред надлежниот суд.

Постапката пред Управниот суд е итна.

Подзаконскиот акт од ставот 1 на овој член ќе се донесе во рок од 15 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

По донесувањето на подзаконскиот акт од ставот 1 на овој член истиот веднаш, а најдоцна во рок од 24 часа се објавува на веб страницата на Министерството за труд и социјална политика.“

#### Член 2

Започнатите постапки за остварување на правата од осигурување во случај на невработеност, ќе се завршат според законот кој важел во моментот на започнување на постапката.

#### Член 3

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“, освен одредбата од членот 64 став 1 точка 1, која се однесува на правото на паричен надоместок од осигурување во случај на невработеност од Законот за вработувањето и осигурување во случај на невработеност („Службен весник на Република Македонија“ број 37/97), која ќе започне да се применува од 30 септември 2011 година.

## L I G J PËR PLOTESIMIN LIGJIT PËR PUNESIM DHE SIGURIM NË RASTE TË PAPUNESISE

### Neni 1

Në Ligjin për punesim dhe sigurim në rast të papunesise ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" nr.37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10 dhe 88/10), pas nenit 81 shtohen dy nene të reja 81-a dhe 81-b, si vijojne:

### "Neni 81-a

Për kërkesen për realizimin e të drejtave të percaktuara me kete ligj veprohet në afat prej 60 ditesh nga dita e paraqitjes së kërkeses nga personi i papunesuar.

Nese Agjencia-Qendra për Punesim nuk miraton aktvendim për realizimin e të drejtave të percaktuara me kete ligj, perkatesisht nuk miraton aktvendim për pranimin ose për refuzimin e kërkeses në afatin nga paragrafi 1 i ketij neni, parashtruesi i kërkeses ka të drejte që në afat prej tri ditesh pune të paraqese kerkese në sekretarine e personit pergjegjes të Agjencise - Qendres për Punesim për miratimin e aktvendimit.

Formen dhe permbajtjen e formularit të kërkeses nga paragrafi 2 i ketij neni i percakton ministri kompetent për punët nga sfera e punes.

Personi pergjegjes i Agjencise-Qendres për Punesim, ka për detyrë që në afat prej pese ditesh pune nga dita e paraqitjes së kërkeses nga paragrafi 2 i ketij neni, në sekretarine e personit pergjegjes të Agjencise-Qendres për Punesim të dorezoje aktvendim me të cilin kerkesa për realizimin e të drejtes eshte pranuar ose refuzuar. Nese personi pergjegjes i Agjencise-Qendres për Punesim nuk ka sekretari, kerkesa paraqitet në sekretarine e selise së organit kompetent.

Me kërkesen nga paragrafi 2 i ketij neni, parashtruesi i kërkeses dorezon edhe kopje të kërkeses nga paragrafi 1 i ketij neni.

Nese personi pergjegjes i Agjencise-Qendres për Punesim nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi 4 i ketij neni, parashtruesi i kërkeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ, në afat prej pese ditesh pune.

Inspektorati Shteteror Administrativ ka për detyrë që në afat prej dhjete ditesh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 6 i ketij neni të kryeje mbikeqyrje inspektuese në Agjencine-Qendren për Punesim sipas kërkeses dhe të percaktoje nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditesh pune nga dita e mbikeqyrjes inspektuese të kryer ta njoftoje parashtruesin e kërkeses për gjendjen e percaktuar gjate mbikeqyrjes së kryer.

Inspektori i Inspektoratit Shteteror Administrativ pas mbikeqyrjes inspektuese të kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e obligon personin pergjegjes të Agjencise - Qendra për punesim, në afat prej dhjete dite të vendose sipas kerkese së paraqitur, perkatesisht ta pranoje ose ta refuzoje kërkesen edhe për masat e marra në afatin e njeje ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ dhe të dorezoje ekzemplar nga akti me të cilin eshte vendosur për kërkesen për aktin e miratuar.

Nese personin pergjegjes i Agjencise - Qendra për Punesim nuk vendos në afatin nga paragrafi 8 i ketij neni, inspektori do të paraqese kerkese për ngritjen e procedures kundervajtese për kundervajtje të vertetuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të percaktoje afat plotesues prej pese ditesh pune, në të cilin personi pergjegjes i Agjencise - Qendres për Punesim do të vendose për kërkesen e paraqitur për çka në afat të njeje do ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesen e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditesh pune do ta informoje parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

Nese personi pergjegjes i Agjencise - Qendres për Punesim nuk vendos në afatin plotesues nga paragrafi 9 i ketij neni, inspektori në afat prej tri ditesh pune do të parashtroje kallezim prokurorit publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkeses.

Nese inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi 7 i ketij neni, parashtuesi i kerkeses në afat prej pese ditesh pune ka të drejte të parashtroje kundershtrim në sekretarine e drejtorit të Inspektoratit Shteteror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Inspektoratit Shteteror Administrativ.

Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ ka për detyre që në afat prej tri ditesh pune nga dita e pranimit, ta shqyrtoje kundershtrimin nga paragrafi 11 i ketij neni dhe nese verteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit nga parashtuesi i kerkeses nga paragrafi 6 ose nuk paraqet fleteparaqitje në pajtim me paragrafin 10 të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqese kerkese për ngritjen e procedures kundervajtjese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktoj afat plotesues prej pese ditesh pune në të cilat inspektori do të kryeje mbikeqyrje në organin kompetent nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditesh pune nga dita e mbikeqyrjes së kryer e informon parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese inspektori nuk vepron edhe në afatin plotesues nga paragrafi 12 i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do t'i paraqese fleteparaqitje prokurorit publik kompetent kunder inspektorit dhe në afat prej tri ditesh pune do ta informoje parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Në rast të paragrafit 13 të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizoj inspektor tjetër që ta zbratoje mbikeqyrjen menjehere.

Në rastet nga paragrafi 14 i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ në afat prej tri ditesh pune do ta informoje parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin 12 të ketij neni, parashtuesi i kerkeses mund t'i parashtroje fleteparaqitje kunder drejtorit prokurorit publik kompetent në afat prej tete ditesh pune.

Nese personi pergjegjes i Agjencise - Qendres për Punesim nuk vendos në afatin nga paragrafi 10 i ketij neni, parashtuesi i kerkeses mund të ngreje kontest administrativ në Gjykatën Administrative.

Procedura në Gjykatën Administrative eshte urgjente.

Akti nenligjor nga paragrafi 3 i ketij neni miratohet në afat prej 15 ditesh nga dita e miratimit të ketij ligji.

Pas miratimit të akteve nenligjore ai menjehere, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrise së Punes dhe Politikës Sociale.

#### Neni 81-b

Nese ministri kompetent për punet nga sfera e punes nuk miraton aktvendim për ankesen për realizimin e të drejtave të percaktuara me kete ligj në afat prej 60 ditesh nga dita e marrjes së ankeses, ankuesi mund ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ në afat prej pese ditesh pune. Formen dhe permbajtjen e njoftimit e percakton ministri kompetent për punet nga sfera e punes.

Inspektorati Shteteror Administrativ ka për detyre që në afat prej dhjete ditesh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 1 i ketij neni, të kryeje mbikeqyrje inspektuese në ministrine kompetente për punet nga sfera e punes dhe të vertetoje nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditesh pune nga dita e mbikeqyrjes inspektuese të kryer ta njoftoje parashtuesin e kerkeses për gjendjen e percaktuar gjate mbikeqyrjes së kryer.

Inspektori nga Inspektorati Shteteror Administrativ pas mbikeqyrjes inspektuese të kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e obligon ministrin kompetent për punet nga sfera e punes, që në afat prej dhjete ditesh të vendose për ankesen, perkatesisht ta pranoje ose ta refuzoj kerkesen dhe për masat e ndermarra në afatin e njejte ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ dhe të dorezoje ekzemplar nga akti me të cilin eshte vendosur për ankesen.

Nese ministri kompetent për punet nga sfera e punes nuk vendos në afatin nga paragrafi 3 i ketij neni, inspektori do të paraqese kerkese për ngritjen e procedures kundervajtjese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të percaktoj afat plotesues prej pese ditesh pune, në të cilin ministrin kompetent për punet nga sfera e punes do të vendose sipas kerkeses së paraqitur për çka në afatin e njejte do ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kerkesen e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditesh pune do ta informoje parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese ministri kompetent për punet nga sfera e punes nuk vendos në afatin plotesues nga paragrafi 4 i ketij neni, inspektori në afat prej tri ditesh pune do t'i parashtroje kallemzim prokurorit publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi 2 i ketij neni, ankuesi në afat prej pese ditesh pune ka të drejte që të parashtroje ankese në sekretarine e ministrit kompetent nga sfera e punes. Nese ministri kompetent për punet nga sfera e punes nuk ka sekretari kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së ministrise.

Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ ka për detyre që në afat prej tri ditesh pune nga dita e pranimit, ta shqyrtoj ankesen nga paragrafi 6 i ketij neni dhe nese verteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit nga parashtuesi i kerkeses nga paragrafi 2 i ketij neni ose nuk paraqet fleteparaqitje në pajtim me paragrafin 5 të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqese kerkese për ngritjen e procedures kundervajtjese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për procedure administrative për inspektorin dhe do të caktoj afat plotesues prej pese ditesh pune në të cilat inspektori do të kryeje mbikeqyrje në organin kompetent nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditesh pune nga dita e mbikeqyrjes së kryer e informon parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese inspektori nuk vepron edhe në afatin plotesues nga paragrafi 7 i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do t'i paraqese fleteparaqitje prokurorit publik kompetent kunder inspektorit dhe në afat prej tri ditesh pune do ta informoje parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Në rast të paragrafit 8 të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizoj inspektor tjetër që ta zbratoje mbikeqyrjen menjehere.

Në rastet nga paragrafi 9 i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ në afat prej tri ditesh pune e informon parashtuesin e kerkeses për masat e ndermarra.

Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin 7 të ketij neni, parashtuesi i kerkeses mund t'i parashtroje fleteparaqitje prokurorit publik kompetent në afat prej tete ditesh pune.

Nese ministri kompetent për punet nga sfera e punes, nuk vendos në afatin nga paragrafi 5 i ketij neni, parashtuesi i kerkeses mund të ngreje kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Procedura në Gjykatën Administrative eshte urgjente.

Akti nenligjor nga paragrafi 1 i ketij neni miratohet në afat prej 15 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Pas miratimit të aktit nenligjor nga paragrafi 1 i ketij neni, ai menjehere, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrise së Punes dhe Politikës Sociale.

#### Neni 2

Procedurat e filluara për realizimin e të drejtave nga sigurimi në rast të papunesise, do të perfundohen sipas ligjit në fuqi në momentin e fillimit të procedures.

#### Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise", pervec dispozitave nga neni 64 paragrafi 1 pika 1, e cila ka të beje në të drejten e kompensimit me para nga sigurimi në rast të papunesise nga Ligji për punesim dhe sigurim në rast të papunesise („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise“ nr. 37/97), e cila do filloje të zbatohet nga 30 shtatori 2011.